

UDHËZUES PËR PROKURIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË NIVEL BASHKIE NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI



Leave
No One
Behind

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e këtij dokumenti është mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB) – faza e dytë, që zbatohet në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNDP në Shqipëri.

Tiranë, Qershor 2023

Përgatitur nga: **Rezarta Sheshaj, konsulente UNDP/LNB**



**Leave
No One
Behind**

United Nations Development Programme
United Nations House
Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

TABELA E LËNDËS

I.	HYRJE	4
	SHKURTIME	5
II.	DOKUMENTE TË KONSULTUARA	6
III.	VËSHTRIM I PËRMBLEDHUR I PROKURIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE BAZUAR NË LIGJIN NR. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”	8
IV.	LIDHJA E LIGJIT PËR SHËRBIMET SHOQËRORE NË SHQIPËRI ME LEGJISLACIONIN E PROKURIMIT PUBLIK PËR SHËRBIMET SOCIALE	11
V.	ORGANIZIMI I NJË PROCEDURE PROKURIMI SIPAS VKM 768 PËR SHËRBIME SOCIALE	13
VI.	SFIDAT NË PROKURIMIN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE PËR SHËRBIME SOCIALE	16
VII.	GJETJE DHE REKOMANDIME	17
	ANEKSI A Hapat e zhvillimit të procedurës për kontratat me vlerë nën 20.000.000 Lekë dhe dokumentat	20

I. HYRJE

Në vitet e fundit, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (139/2015), Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror (121/2016), vendimi nr. 768, datë 15.12.2021, i Këshillit të Ministrave për “Përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojet e shërbimeve të veçanta për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullat e detajuara për prokurimin e tyre”, mundësojnë prokurimin e fondeve publike për realizimin e shërbimeve shoqërore në nivel lokal duke gatantuar efikasitet dhe efikasitet, mirëpërdorim të fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF), nxitjen e konkurrencën, siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues, siguron integritet, besim publik dhe transparencë. Prokurimi i shërbimeve shoqërore lejon transferimin e fondeve publike nga njësitë e qeverisjes vendore/bashkitë tek OJF-të, bazuar në planet sociale vendore.

Plotësimi i akteve nënligjore për prokurimin e shërbimeve shoqërore (dhjetor 2021), bën që njësitë e qeverisjes vendore/bashkitë të fuqizojnë shërbimet shoqërore ekzistuese dhe ngritjen e shërbimeve të reja, duke zgjeruar shportën e shërbimeve shoqërore dhe plotësuar nevojat e grupeve në nevojë. Legjislacioni për prokurimin e shërbimeve shoqërore përcakton: i) procedurat që ndjek njësitë e qeverisjes vendore/bashkia në prokurimin e fondeve publike; ii) detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e specialistëve që marrin pjesë në prokurim; iii) llojin e procedurës së përzgjedhur sipas vlerës së kontratës që prokurohet; iv) mënyrën e publikimit; v) vlerëson raportin cmim-cilësi për vlerësimin e propozimit më të mirë në përzgjedhjen e OJF që do të ofrojë shërbimin; vi) këkon garantimin e transparencës dhe barazisë gjatë gjithë procesit të prokurimit.

Gjatë kësaj kohe rezulton se njësitë e qeverisjes vendore/bashkitë kanë vështirësi në zbatimin në praktikë të prokurimit publik të shërbimeve shoqërore.

Qëllimi i raportit është asistimi i stafit të Departamentit të Mbrojtjes Sociale dhe Përfshirjes Sociale të Bashkisë së Tiranës, në procedurat e prokurimit për ofrimin e shërbimeve shoqërore në partneritet me organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet hartimit të udhëzuesit për prokurimin e shërbimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky dokument është mbështetur nga UNDP Albania, në kuadrin e programit “Askush të mos mbetet pas” (faza e dytë).

SHKURTIME

APP	Agjensia e Prokurimit Publik
LPP	Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik “
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Njësia	Njësia e prokurimit (ose një strukturë të posaçme)
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
VKM 768	VKM nr 768 datë 12.12.2021
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

II. DOKUMENTE TË KONSULTUARA

Kuadri ligjor

Ligj Nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2019, datë 20.6.2019)

Ligj Nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën E Shqipërisë”

Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik “

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale Në RSH”

Ligj Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin E Sistemit Buxhetor Në Republikën E Shqipërisë, i Ndryshuar

Akte nënligjore (VKM)

Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Vendim Nr. 768 Datë 15.12.2021 “ Për Përcaktimin e Llojeve të Shërbimeve Sociale dhe Shërbimeve të Tjera Specifike, Llojeve të Shërbimeve të Veçanta, për të Cilat Mund të Rezervohet e Drejta e Pjesëmarrjes së Organizatave në Procedurat e Prokurimit Publik, si dhe Rregullave të Detajuara për Prokurimin e Tyre

Vendim Nr. 110, Datë 1.12.2022 Autorizim i Ndhmës Shtetërore “Për Ndërmarrjet Sociale”

Vendim Nr. 150, Datë 20.3.2019 Për Metodologjinë e Llogaritjes së Fondeve për Financimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

Udhëzim Nr. 689, Datë 2.10.2018 Për Nivelin e Kuotave të Shpenzimeve për Ushqime, të Institucioneve Publike Rezidenciale e Komunitare të Përkujdesjes Shoqërore

Vendim Nr. 518, Datë 4.9.2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për Përfitimin e tyre dhe Masën e Shumës për Shpenzime Personale për Përfituesit e Shërbimit të Organizuar”

Vendim Nr. 252, Datë 20.4.2023 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, Të Planit të saj të Veprimit 2023–2025 e të Pasaportës së Indikatorëve

Udhëzime

Udhëzues Fondi Social 2023 Thirrje për Propozime për Njësitë e Qeverisjes Vendore Fondi Social për Shërbime të Kujdesit Shoqëror

Dokumenta standade

Dokumentat Standarde të Tenderit për Procedurën e Hapur Shërbime

Dokumentat Standarde të Prokurimit të Shërbimeve Sociale dhe Shërbimeve të tjera Specifike

Të tjera

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale

Metodologjia për Alokimin e Fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile Bashkia Tiranë

Buletinet e Prokurimit Publik (Arkiva e APP)

III. VËSHTRIM I PËRMBLEDHUR I PROKURIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE BAZUAR NË LIGJIN NR. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”

Prokurimi i fondeve publike në Shqipëri është rregulluar me Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (në vijim LPP). LPP përcakton¹ rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të LPP, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike. Qëllim i LPP² është: **a)** të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; **b)** të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; **c)** të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; **ç)** të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; **d)** të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; **dh)** të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Parime të përgjithshme³ mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon LPP janë:

1. Autoritetet/Bashkitë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet/Bashkitë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të LPP ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet/Bashkitë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Prokurimi i shërbimeve sociale përcaktohet në Kreu XII të LPP, neni 100 “Prokurimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike”.

Parimet për shpalljen e kontratave fituese për shërbime sociale sipas LPP janë:

1. Transparenca dhe trajtim i barabartë i operatorëve ekonomikë. Rregullat procedurale që zbatohen, përcaktohen në mënyrë të tillë që t’u lejojnë autoriteteve ose enteve kontraktore të marrin në konsideratë specifikat e shërbimeve në fjalë.
2. Gagarantim i cilësisë, vazhdimësisë, aksesueshmërisë, kostos, efektivitetit, disponueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes në shërbime, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël, përfshirjen dhe fuqizimin e përdoruesve dhe inovacionin.

1 Neni 1 i ligjit nr 162/2020 “Për prokurimin publik”

2 Neni 2 i ligjit nr 162/2020 “Për prokurimin publik”

3 Neni 3 i ligjit nr 162/2020 “Për prokurimin publik”

Autoritetet/Bashkitë mund të parashikojnë që zgjedhja e ofruesit të shërbimit të bëhet mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale.

LPP në Nenin 103 të tij parashikon lidhjen e Kontratave të rezervuara për shërbime të caktuara. Në këto kontrata Autoritetet /Bashkitë u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta, veçanërisht për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore. Organizatat duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) qëllimi i saj është përmbushja e një misioni të shërbimit publik, që lidhet me ofrimin e shërbimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni; b) fitimet investohen sërish për përmbushjen e objektivave të organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) strukturat drejtuese ose të pronësisë së organizatës bazohen në parimet e pronësisë dhe pjesëmarrjes së punonjësve ose kërkojnë pjesëmarrje aktive të punonjësve, përdoruesve ose palëve të interesuara; dhe ç) gjatë tri viteve të fundit, organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për shërbimet e përcaktuara në këtë nen nga autoriteti ose enti kontraktor që prokuron kontratën. Kohëzgjatja e kontratës së lidhur sipas këtij neni nuk mund të jetë më shumë se tre vjet. Autoriteti/ Bashkia përcakton mundësinë për kontratën e rezervuar në njoftimin e kryer sipas nenit 101 të LPP.

Neni 103 i LPP

Lejon organizatat që plotësojnë kriteret e caktuara si dhe lehtëson përfshijen në procedurat e prokurimit të shërbimeve sociale të ndërmarrjeve sociale të përkufizuara nga Ligji në Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë". Neni nxit Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në parashikimin dhe përzgjedhjen e ndërmarrjeve sociale si ofrues të shërbimeve shoqërore.

Nga ana tjetër, për të mos cënuar parimin e transparencës dhe trajtim të barabartë të operatorëve, neni, vendos një kufizim 3 vjeçar brenda të cilit organizatat të mos jenë shpallur fituese të kontratave të ngjashme.

Rregullat e detajuara për prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, përcaktohen në VKM nr 768 datë 12.12.2021 (referuar në vijim Vendimi 768).

Në zbatim të Vendimit 768, Autoritetet /Bashkitë:

- ▶ duhet të veprojnë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomike dhe nxitjes së konkurrencës,
- ▶ janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën,
- ▶ duhet të garantojnë cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto-efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime.
- ▶ duhet të marrin në konsideratë, gjithashtu, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerezit në nevojë dhe grupet vulnerabël.
- ▶ përcaktimet e parashikuara në këtë vendim të jenë njësoj të zbatueshme për operatorët ekonomike, si persona fizikë ose juridikë apo atyre në cilësinë e organizatave jofitimprurëse, si dhe për bashkimet e tyre.

- ▶ për çdo fazë të procesit, që nuk gjen rregullim konkret në këtë vendim, të zbatojnë parashikimet e LPP-se dhe rregullave të prokurimit publik.

Bazuar në VKM768⁴ Autoritetet/Bashkitë, që synojnë të japin një kontratë publike për shërbimet shoqërore, e bëjnë të ditur qëllimin e tyre, nëpërmjet njerës prej mënyrave të mëposhtme:

1. Njoftimit:

- ▶ të kontratës;
- ▶ paraprak të informacionit ose njoftimit periodik të informacionit ;
- ▶ për ekzistencën e një sistemi kualifikimi.

2. Mundësisë për kontratën e rezervuar për organizata

Autoritetet/Bashkitë, publikojnë gjithashtu rezultatet e procedurës së prokurimit nëpërmjet një njoftimi për dhënien e kontratës.

4 Neni nr 2 i VKM 768

IV. LIDHJA E LIGJIT PËR SHËRBIMET SHOQËRORE NË SHQIPËRI ME LEGJISLACIONIN E PROKURIMIT PUBLIK PËR SHËRBIMET SOCIALE

Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcakton se zbatimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore, është përgjegjësi e organeve publike të ngarkuara me këtë detyrë, në nivel qendror dhe vendor. Institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë: a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë; b) qarku; c) bashkia. VKM Nr.150, datë 20.3.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social” në zbatim të Ligjit nr 121/2016 ka për qëllim hartimin e metodologjisë së llogaritjes të fondeve të financimit të shërbimeve sociale dhe të shpërndarjes së tyre nëpërmjet vendosjes së kriterëve dhe hapave që do ndjekë procesi. Procesi i realizimit të procedurave të financimit nga buxheti i shtetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, kryhet si në kuadrin e Fondit Social, ashtu dhe të transfertave të tjera, përfshirë këtu dhe financimin e shërbimeve të specializuara dhe unike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel qarku, si dhe linjat kombëtare të këshillimit telefonik për gratë dhe fëmijët, që kanë marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

LPP përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. LPP⁵ përcakton kuptimin e terminologjisë “Prokurim” dhe sipas tij prokurim është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

“Fondet publike” të cilat i nënshtrohen prokurimit sipas LPP janë:

- a) çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;
- ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.

⁵ Citim nga LPP

Sa më sipër përdorimi i financimeve publike për shërbimet e kujdesit social, duke qenë fonde publike i nënshtrohen kërkesave të LPP.

Fondi Social (me burim buxhetin e shtetit) dhe fondet e buxhetit vendor për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel bashkie janë objekt i LPP dhe kalojnë në procesin e prokurimit. Duke qenë se Fondi Social mbështet njësitë e qeverisjes vendore dhe qarqet nëpërmjet financimit të shërbimeve në tri vite⁶, fondi i tre viteve i nënshtrohet procesit të prokurimit. LPP parashikon marrëveshjen kuadër, me afat deri në 3 vite, si një nga mjetet e prokurimit që lehtëson përdorimin e Fondit Social në nivel qarku dhe bashkie.

6 Jo më shumë se 90% e kostos për vitin e parë të ofrimit të shërbimeve; Jo më shumë se 60% e kostos për vitin e dytë të ofrimit të shërbimeve; 30% në vitet në vijim.

V. ORGANIZIMI I NJË PROCEDURE PROKURIMI SIPAS VKM 768 PËR SHËRBIME SOCIALE

Hapi i parë: Identifikimi i nevojave për shërbime shoqërore.

Identifikimi i nevojave për shërbime shoqërore bazohet në Planet Lokale të Mbrojtjes Sociale. Titullari i Bashkisë informohet për nevojën për shërbimin shoqëror.

Hapi i dytë: Titullari i autoritetit ose entit kontraktor apo personi i autorizuar ngarkon njësinë e prokurimit ose një strukturë të posaçme⁷ (më poshtë referuar Njësia) për hartimin e Termave të Referencës/specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit⁸ të procedurës (përfshirë testimin e tregut).

Hapi i tretë: Përcaktimi i procedurës së prokurimit publik

Bazuar në VKM 768 përdoret procedura e hapur për shërbimet sociale për kufijtë monetarë:

- a) për kontrata klasike, 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) leke;
- b) për kontrata sektoriale, 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) lekë,

Procedurat e prokurimit për shërbimet sociale sipas kufijve monetarë, zhvillohen me mjete elektronike në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP sipas udhezimeve të APP-se.

Sipas VKM 768 për shërbimet sociale, vlera e përlllogaritur e të cilëve brënda një viti kalendarik nuk është më e madhe se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, autoriteti ose enti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në këtë rast, Autoriteti/Bashkia detyrohet që në dhënien e kontratave të respektojë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 1 të VKM 768.

Hapi i katërt: Titullari i Autoritetit /Bashkisë apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit.

Urdhëri i prokurimit përmban: objektin e prokurimit, vlerën e përlllogaritur të kontratës dhe autorizohet njësia e prokurimit për vijimin e procesit.

Bazuar në Urdhërin e Prokurimit, Njësia, përgatit dokumentet e procedurës konkrete, të cilat duhet të japin gjithë informacionin e nevojshëm për operatorët ekonomikë, në përgatitjen e ofertave të tyre.

Njësia bazohet në:

- a) dokumentet standarde të prokurimit të shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik për kontratat klasike 90.000.000 lekë dhe kontratat sektoriale 120.000.000 lekë. Për këto kontrata, **procedurat e prokurimit për shërbimet sociale, zhvillohen me mjete elektronike në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP sipas udhezimeve të APP-se.**

⁷ Specifikimet teknike hartohen nga departamenti/drejtorja që ka identifikuar nevojën për shërbimin social

⁸ Përlllogaritja e fondit limit në bashkëpunim me njësinë e prokurimit të institucionet, me departamentin/drejtorinë që ka hartuar specifikimet teknike dhe me një specialist të departamentit/drejtorisë së buxhetit apo financave të institucionit

- b) Procedurat e prokurimit për shërbime sociale nën 20.000.000 lekë brenda vitit kalendarik, Autoriteti/Bashkia harton dokumenta⁹ të cilat respektojnë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 1 të VKM 768. Për këto kontrata **procedura e përzgjedhjes nuk zhvillohet me mjete elektronike në sistemin e prokurimit publik, por Autoriteti / Bashkia bën publikimin e Njoftimit të kontratës¹⁰ në rubrikën “Të tjera”¹¹ në Buletinin e prokurimit publik të APP-së.**

Njësia përgatit dokumentat e procedurës. Ato (dokumentat) duhet të japin gjithë informacionin e nevojshëm për operatorët ekonomikë, në përgatitjen e ofertave të tyre.

Pjesë e Dokumentave të procedurave të prokurimit për shërbimet sociale janë:

- ▶ Kriteret e pranimit për shërbimet shoqërore.
- ▶ Kriteret e përzgjedhjes mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë cmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale.

Dokumentat përfshijnë të paktën:

- a) njoftimin e kontratës;
- b) njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
- c) njoftimin për ekzistencën e sistemit të kualifikimit;
- d) formularin e kriterëve të pranimit;kriteret e përzgjedhjes;
- e) termat e references për shërbimin;
- f) afatin e ekzekutimit dhe çdo të dhënë tjetër që përshkruan kërkesat e objektit të prokurimit dhe vlerësohet e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës;
- g) formularin përmbledhës të deklaramentit; njoftimin e fituesit;
- h) njoftimin e fituesit në përfundim të afateve të ankimit;
- i) formularin e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;
- j) formularin e dërgimit të kundërshtimeve nga operatorët ekonomikë të interesuar;
- k) Formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar;
- l) Formularin e anulimit

Hapi i pestë: Shpallja e procedurës

Autoriteti/Bashkia shpall një njoftim, sipas nenit 3, të këtij vendimi, i cili publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave përcaktohet nga autoriteti /Bashkia, në varësi të kompleksitetit të shërbimit që prokurohet dhe kohës së nevojshme që mund t’u duhet kandidatëve në përgatitjen e ofertave të tyre. Në çdo rast, afati minimal do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin monetar.

⁹ Aneksi A

¹⁰ Pika 2 neni 5 / VKM 768

¹¹ Arkiva e APP / Buletini

Hapi i gjashtë: Nxjerrja e Urdhërit për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave

Titullari i autoritetit/Bashkisë apo personi i autorizuar nxjerr urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, sic përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Anëtarët e njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave apo struktura të ngarkuara gjatë kryerjes së procesit të prokurimit, duhet të mbajnë në konsideratë respektimin e rregullave që lidhen me shmangien e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve në LPP. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë detyrim të deklarojnë për gjendjen e konfliktit të interesit edhe me ofertuesit, në momentin e hapjes së ofertave.

Hapi i shtatë: Shqyrtimi i ofertave

Operatorët ekonomikë të interesuar paraqesin ofertën dhe dokumentet e kërkuara nga Autoriteti /Bashkia në njoftimin e kontratës, për të provuar se zotërojnë kapacitetet ligjore, ekonomike, teknike e profesionale. Plotesimi i kriterëve të pranimit bëhet sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik.

Autoriteti/Bashkia shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomike në bazë të kriterëve për kualifikim jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës për procedurat mbi kufirin monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin monetar.

Nëse dy ose më shumë oferta kanë pikë të njëjta, atëhere fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët, si dhe korigjimi i gabimeve aritmetike bëhet sipas parashikimeve të rregullave të prokurimit publik.

Hapi i tetë: Njoftimi i fituesit

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimin e fituesit të procedurës.

Anulimi i procedurës

Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, sipas parashikimeve të LPP-se dhe rregullave të prokurimit publik.

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës, autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimin e anulimit të procedurës.

Ankimi

Rregullat e parashikuara në LPP dhe rregullat e prokurimit publik për paraqitjen e shqyrtimin e ankesave zbatohen edhe për procedurën e prokurimit, për shërbimet sociale.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Autoritetet /Bashkia, që kanë dhënë një kontratë publike për kategoritë e shërbimeve sociale publikojnë një njoftim për dhënien e kontratës, sipas përcaktimit në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik.

VI. SFIDAT NË PROKURIMIN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE PËR SHËRBIME SOCIALE

VKM 768 dhe hartimi i dokumentave standarde për zbatimin e tij janë një përgjigjësi ligjore për prokurimin e fondeve publike për shërbime sociale. Ndonëse të miratuara rreth 1 vit më parë, ato kanë gjetur zbatim (të limituar) më shumë me Fondin Social. Njësitë e qeverisjes vendore kanë tentuar prokurimin e fondeve të veta lokale për shërbime sociale, por janë ndeshur me vështirësi që lidhen me kuptimin dhe zbatimin e procedurave të parashikuara në këtë VKM.

Sfidat me të cilat përballen Bashkitë në prokurimin dhe zbatimin e kontratave për shërbime sociale konsistojnë në:

- ▶ Kapacitete njerëzore të limituara për realizimin e procedurave prokuruese sipas legjislacionit shqiptar.
- ▶ Vështirësi për llogaritjen e fondit limit për prokurimin e shërbimeve sociale.
- ▶ Paqartësi në realizimin e procedurave për shërbime sociale me vlerë nën 20.000.000 lekë në vit.
- ▶ Diferenca të papërdorura të fondeve të alokuara nga Fondi Social për ofrimin e shërbimeve sociale.
- ▶ Përzgjedhjen e procedurës për kontraktimin e organizatave të cilat mbështesin Bashkinë në ofrimin e shërbimeve sociale.
- ▶ Në përdorimin e marrëveshjes kuadër për përzgjedhjen e një organizate/ofrues shërbimi për garantimin e shërbimeve sociale mbi 1 vit.
- ▶ Prokurimin e shërbimeve sociale bazuar në Kontratën e Rezervuar.
- ▶ Hezitim të Bashkive të ndërtojnë me vendim këshilli (me fondet e veta), kriteret lokale që parashikojnë mbulimin pjesor të kostove indirekte¹² në ofrimin e shërbimeve sociale në formë projektesh.

¹² Vendosi e nje kuote, %, në mbulimin e kostove indirekte sikurse parashikohen nga PRAG/ BE

VII. GJETJE DHE REKOMANDIME

Gjatë realizimit të shërbimit të konsulencës, nga konsultimi i kuadrit ligjor, nga takimet me profesionistë të Bashkisë Tiranë dhe OJF që ofrojnë shërbime shoqërore të financuara nga MSHMS (Fondi Social), raportet vjetore të institucioneve, Studime¹³ të realizuara nga partnerë dhe Donatorë me fokus shërbimet shoqërore dhe zbatimi i prokurimeve të shërbimeve shoqërore në praktikë, kanë rezultuar gjetjet e mëposhtme:

1. Stafet e bashkive kanë njohuri të pamjaftueshme dhe zbatojnë pak në praktike Marrëveshjen Kuadër ose Kontratat e Rezervuara në prokurimin dhe kontraktimin e shërbimeve sociale si me fondet e veta ashtu edhe me Fondin Social.

Rekomandohet që për prokurimin e shërbime shoqërore të zbatohet ligji nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM 768 datë 15.12.2021 për Marrëveshjen Kuadër ose Kontrata e Rezervuar:

1.1 Përdorimit të Marrëveshjes Kuadër për realizimin e prokurimit dhe kontraktimit të shërbimeve shoqërore dhe përdorimin e plotë të Fondit Social. Marrëveshja Kuadër mund të lidhet për një periudhë 4 vjeçare nga momenti i nënshkrimit të saj, ndërsa kontrata lidhet për periudhe jo më shumë se 3 vjeçarë, duke përfshirë periudhën 3 vjeçare të financimit nga Fondi Social. Me dorëzimin e aplikimeve për Fond Social, Bashkia fillon procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e OJF për ofrimin e shërbimit të që do të financohet nga Fondi Social, duke vendosur një afat kohor të dorëzimit të ofertave në përshtatje me përgjigjen për shpalljen fituese të aplikimit nga MSHMS. Kjo do të bënte që vonesat në ofrimin e shërbimit social për vitin e parë të lidheshin me periudhën e alokimit të fondit nga MSHMS dhe do të ishte argumentim bindës për rialokimin e fondeve të porealizuara.

1.2 Përdorimit të Kontratës së Rezervuar për realizimin e prokurimit dhe kontraktimit të shërbimeve shoqërore dhe përdorimin e plotë të Fondit Social.

2. Njësitë e qeverisjes vendore për shkak të mungesës së burimeve të financimit, aplikojnë për Fond Social në partneritet me OJF. Kontratat njëvjeçare të nënshkruara me OJF janë shoqëruar me problematika të zbatimit të fondeve nga Thesaret e rretheve në vitin e dytë të financimit. Ato (Thesaret) u kërkojnë njësitë të qeverisjes vendore procedura prokurimi për vitin e dytë ose ekzistencën e marrëveshjes kuadër. Një proces i dytë prokurimi, në vitin e dytë, për një shërbim të ngritur nga OJF partnere shoqërohet me ndërpreje të shërbimit nga kjo e fundit për sa kohë zgjat procedura e prokurimit. Gjithashtu mund të ndodhë që fituese në procedurën e realizuar në vitin e dytë të jetë një OJF tjetër që ka ofruar një raport më të mirë të raportit cilësi-cmim, por që nuk njihet nga MSHMS, pasi nuk ka qenë partnere në propozim.

Rekomandohet që njësitë e qeverisjes vendore për projekte më shumë se 1 vit, të financuara nga Fondi Social, të parashikojnë marrëveshjen kuadër, konform kohëzgjatjes së projektit me OJF për realizimin e shërbimeve shoqërore.

13 Si “Fondi Social – një realitet mes sfidash locale” realizuar nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), me mbështetjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF),

3. Përdorim dhe realizim jo i plotë, respektivisht i fondeve dhe shërbimeve shoqërore të planifikuara, financuar nga Fondit Social (kryesisht alokuar në vitin e parë). Në vitin e parë të financimit, MSHMS alokon fondet pas tremujorit të parë të vitit. Pas financimit, nis procedura e prokurimit të shërbimit që zgjasin mbi një muaj¹⁴ (ngritja e urdhërit të prokurimit, publikimi, procesi i pranimit të ofertave, vlerësimi i tyre dhe përzgjedhja e organizatës fituese, publikimi i njoftimit të fituesit, sqarimi i ankesave, lidhja e kontratës). Në përfundim të procedurës së prokurimit të shërbimeve fillon zbatimi projekteve të financuara nga Fondi Social. Në këto kushte, megjithëse parashikimi i fondeve dhe aktiviteteve në projektet e financuara nga Fondi Social bëhet për periudhë një vjecare, realizimi i tyre në praktikë në vitin e parë është i pjesshëm (duke realizuar pjesërisht aktivitetet / rezultatet e parashikuara dhe mospërdorim të fondit social të alokuar).

Rekomandohet rritja e kapaciteteve të punonjësve të Bashkive në lidhje me procedurat e prokurimit të shërbimeve sociale, zbatimin në praktike të Marrëveshjes Kuadër dhe/ose Kontratës së Rezervuar si me fondet e veta ashtu edhe me Fondin Social

4. MSHMS ka parashikuar për njësitë e qeverisjes vendore mundësinë e rialokimit të fondeve nga Fondi Social (që nuk janë përdorur), duke i dhënë mundësinë e përdorimit të tyre brenda vitit (duke mirë-argumentuar kërkesën për rialokim). Njësitë e qeverisjes vendore për shkak të mungesës së informacionit apo mos respektim të afatit për paraqitjen e kërkesës për rialokim në shumë raste kanë humbur mundësinë për rialokim duke mos përfutuar të gjithë fondin e alokuar për to. Kjo situatë është më e shpeshtë në vitin e parë dhe të dytë të financimit për bashkitë të cilat aplikojnë për herë të parë tek Fondi Social.

Rekomandohet rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të bashkive që përfitojnë për herë të parë nga Fondi Social. Brenda muajit të parë të nënshkrimit të marrëveshjes me MSHMS, kjo e fundit të planifikojë trajnime për procedurat që duhet të ndjekë bashkia në përdorim efikas të Fondit Social.

5. Jo të gjitha njësitë e qeverisjes vendore kanë aplikuar për Fond Social. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së kapaciteteve të njërive të qeverisjes vendore për hartimin e planeve sociale dhe përgatitjen e praktikave për aplikim për Fond Social.

Rekomandohet rritja e kapaciteteve të punonjësve të njërive të qeverisjes vendore dhe asistimi i tyre për hartimin e planeve sociale dhe përgatitjen e praktikave për aplikim për Fond Social.

6. Përlllogaritja e fondit limit nga specialistët e Bashkisë për prokurimin e shërbimeve sociale rezulton e vështirë për shkak të:

- ▶ Mungesës së kostimit të shërbimeve sociale për të gjitha kategoritë në nevojë dhe për çdo tipologji shërbimi.
- ▶ Burime të limituara deri në mungesë të shërbimeve të ngjashme të mëparshme të Bashkisë Tiranë ku mund të referohet përlllogaritja e fondit limit.
- ▶ Pamundësi të testimit të tregut për shkak të burime të limituara në treg të ofertave (pothuajse mungojnë) për shërbime shoqërore që mund të ndihmojnë në dhënie të ofertave për përlllogaritjen e fondit limit për shërbime të caktuara sociale

14 Në varësi të procedurës së përzgjedhur kohëzgjatja e një procedure zgjat nga 30-60 ditë.

- ▶ Vështirësi në përlogaritjen e fondit limit bazuar në analizimin e shpenzimeve të shërbimeve sociale duke i ndarë ato (shërbimet) në: i) shpenzime për administrimin dhe realizimin e aktivitetit (kosto indirekte); ii) shpenzime për aktivitetet dhe furnizime (kosto e ndryshyeshme); iii) shpenzime për dukshmërinë (kosto e direkte).
- ▶ Njësitë e qeverisjes vendore me fondet e veta hezitojnë të ndërtojnë, me vendim këshilli, kritere lokale që parashikojnë mbulimin pjesor të kostove indirekte¹⁵ në ofrimin e shërbimeve sociale në formë projektesh.

Rekomandohet që në përlogaritjen e fondit limit për shërbime shoqërore në nivel bashkie grupi i punës duhet të bazohet në: i) nivelin e pagave të punonjësve të bashkisë që prokuron shërbimin për pagat e stafit të projektit dhe personelit që do të ofrojë shërbimet ; ii) Standardet e vendosura nga MSHMS për kuotën ushqimore për shërbimet rezidenciale apo ditore për kategoritë në nevojë ; iii) respektimin e standardeve të miratuara nga MSHMS në ofrimin e shërbimeve dhe përzgjedhjen e ambjenteve të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve shoqërore (duke ruajtur raportet staf/përfitues, sipërfaqe për përfitues, kushte të mira / pa lagështirë, myk etj) ; iv) parashikimin e shpenzimeve të tjera operacionale duke ju referuar shpenzimeve të ngjashme të realizuara nga shërbimet e ofruara nga vetë bashkia (higjena, mirëmbajta, realizimi i aktiviteteve të ndryshme etj).

7. Agjensia e Prokurimit Publik (APP) nuk i ka dhënë zgjidhje paqartësisë së Bashkisë Tiranë në lidhje me shërbimet shoqërore me vlerë nën 20.000.000 lekë. Në këtë përgjigje APP shprehet se:
- i. Shërbimet që brënda një vitit kalendarik kanë një fond nën vlerën 20.000.000 lekë nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit.
 - ii. AK do të kryejë procedurën duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës.

Pra, bazuar në këtë përgjigje Bashkitë:

- ▶ Nuk kanë detyrim ligjor të ndjekin procedurë të hapur sipas legjislacionit shqiptar për prokurimin e shërbimit dhe,
- ▶ Duhet të ndërtojnë një procedurë përzgjedhje për ofrimin e shërbimeve sociale duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomike dhe nxitjen e konkurrencës.

Rekomandohet për realizimin e kontratave për shërbime shoqërore me vlerë nën 20.000.000 lekë, përdorimi i praktikës së përzgjedhjes së OJF për ofrimin e shërbimit social dhe setit të dokumentave, të hartuar gjatë konsulences, prezantuar në Aneksin A.

¹⁵ Vendosjen e nje kuote, %, në mbulimin e kostove indirekte sikurse parashikohen nga PRAG/ BE

ANEKSI A

Hapat e zhvillimit të procedurës për kontratat me vlerë nën 20.000.000 Lekë dhe dokumentat

1. Hapat e Zhvillimit të prodesurës për kontratat për shërbime shoqërore nën vlerën 20.000.000 lekë

Hapi i parë: Identifikimi i nevojave për shërbime shoqërore.

Identifikimi i nevojave për shërbime shoqërore bazohet në Planet Lokale të Mbrojtjes Sociale. Informimi i titullarit të Bashkisë për nevojën për shërbimin shoqërorë.

Hapi i dytë: Titullari i Bashkisë apo personi i autorizuar ngre 2 (dy) grupe punës: 1) grupi i parë për hartimin e Termave të Referencës/specifikimeve teknike dhe; ii) grupi i dytë për llogaritjen e fondit (përfshirë testimin e tregut).

Bazuar në termat e referencës të hartuar nga grupi i parë, grupi I dytë bën përllogaritjen e fondit të nevojshëm për kontratën e shërbimit shoqëror.

Hapi i tretë: Titullari i Bashkisë apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin për zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e OJF-së për ofrimin e shërbimit shoqëror të kërkuar.

Urdhëri përmban: objektin, vlerën e përllogaritur të kontratës, burimin e financimit, njësinë për zhvillimin e procedurës.

Bazuar në Urdhërin, Njësia, përgatit dokumentet e procedurës, të cilat duhet të japin gjithë informacionin e nevojshëm për OJF-të, në përgatitjen e ofertave të tyre. Ato (dokumentat) duhet të japin gjithë informacionin e nevojshëm për OJF-të, në përgatitjen e ofertave të tyre.

Pjesë e Dokumentave të procedurave për përzgjedhjen e OJF –së për ofrimin e shërbimeve sociale janë:

- ▶ Kriteret e pranimit për shërbimet shoqërore.
- ▶ Kriteret e përzgjedhjes mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mire cmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale.

Dokumentat përfshijnë të paktën:

Njoftimi i Kontratës

Formulari i Propozimit

Propozimit Financiar (Buxheti)

Formulari i Kriteve të Pranimit

Kriteret e Përzgjedhjes

Termet e Referencës për Shërbimet

Afati i Ekzekutimit (dhe çdo të dhënë tjetër që përshkruan kërkesat e procedurës së përzgjedhjes)

Formulari Përmbledhës i Deklarimit

Formulari i Njoftimit të Propozimit Renditur i pari

Formulari i Ankesës

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

Formulari i Njoftimit të Anulimit

Hapi i katërt: Shpallja e procedurës

Autoriteti/Bashkia shpall njoftimin i cili publikohet në rubrikën “Të tjera” në Buletin e Njoftimeve Publike të APP-së.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave përcaktohet nga autoriteti /Bashkia, në varësi të kompleksitetit të shërbimit dhe kohës së nevojshme që mund t’u duhet kandidatëve në përgatitjen e ofertave të tyre. Në çdo rast, afati minimal do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Hapi i pestë: Nxjerrja e Urdhërit për krijimin e komisionit të vlerësimit të propozimeve

Titullari i autoritetit/Bashkisë apo personi i autorizuar nxjerr urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të propozimeve.

Anëtarët e njësisë dhe të komisionit të vlerësimit të propozimeve apo struktura të ngarkuara gjatë kryerjes së procedurës, duhet të mbajnë në konsideratë respektimin e rregullave që lidhen me shmangien e konfliktit të interesit. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të propozimeve kanë detyrim të deklarojnë për gjendjen e konfliktit të interesit edhe me ofertuesit, në momentin e hapjes së propozimeve.

Hapi i gjashtë: Shqyrtimi i propozimeve

OJF-të e interesuara paraqesin propozimin dhe dokumentet e kërkuara nga Autoriteti /Bashkia në njoftimin e kontratës, për të provuar se zotërojnë kapacitetet ligjore, ekonomike, teknike e profesionale.

Autoriteti/Bashkia shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga OJF-të në bazë të kriteve për kualifikim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e hapjes së procedurës.

Nëse dy ose më shumë propozime kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të OJF-ve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet OJF-ve. Mospjesëmarrja e tyre gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

I gjithë procesi i vlerësimit dokumentohet nëpërmjet mbajtjes së procesvebalit nga ana e komisionit të vlerësimit.

Njësia në përfundim hartohen raportin përfundimtar drejtuar titullarit të Bashkisë i cili miraton OJF e renditur e para.

Hapi i shtatë: Njoftimi ifituesit

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i procesit të vlerësimit të propozimeve, autoriteti / Bashkia dërgon për publikim në rubrikën “Të tjera” në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-së njoftimin e OJF-së renditur e para.

Anulimi i procedurës

Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e në çdo moment duke argumentuar motivin e anulimit.

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës, autoriteti /Bashkia dërgon për publikim në rubrikën “Të tjera” në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-së njoftimin e anulimit të procedurës.

Ankimi

OJF-të jokualifikuese gëzojnë të drejtën e ankimit pranë Autoritetit/Bashkisë Brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Ankimi bëhet me shkrim sipas formularit të kërkuar në dokumenta.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Autoritetet /Bashkia, që kanë dhënë një kontratë publike për kategoritë e shërbimeve sociale publikojnë një njoftim për dhënien e kontratës në rubrikën “Të tjera” në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-së.

2. Dokumenta të procedurës për shërbime sociale me vlerë nën 20 000 000 (njëzet milione) lekë

LISTA E DOKUMENTEVE

Shtojca 1: Njoftimi i Kontratës

Shtojca 2: Formulari i Propozimit

Shtojca 3: Propozimit Financiar (Buxheti)

Shtojca 4: Formulari i Kritereve të Pranimit

Shtojca 5: Kriteret e Përzgjedhjes

Shtojca 6: Termat e Referencës për Shërbimet

Shtojca 7: Afati i Ekzekutimit (dhe çdo të dhënë tjetër që përshkruan kërkesat e procedurës së përzgjedhjes)

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Deklarimit

Shtojca 9: Formulari i Njoftimit të Propozimit Renditur i pari

Shtojca 10: Formulari i Ankesës

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Anulimit

Shtojca 1

NJOFTIMI I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë)

Seksioni 1: BASHKIA TIRANË

1.1 Emri dhe adresa Bashkisë Tiranë

Emri:	
Adresa:	
Tel/Faks:	
E-mail:	
Adresa e ueb-faqes:	
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	

1.2 Lloji Entit

Njësi e autoriteteve vendore

Të tjera

1.3 Kontratë e rezervuar

Po

Jo

Nese po, specifikoni:

- Kontrata është e rezervuar për organizata të cilat punësojnë njerëz me aftësi të kufizuara dhe OJF-të që synojnë integrimin social dhe profesional të personave me aftësi të kufizuara ose personave në nevojë.
- Zbatimi i kontratës kufizohet në kuadrin e programeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: _____

2.1 Përshkrimi i shkurtër i kontratës

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: _____ ALL (_____
_____vlera më fjalë) , pa TVSH.
2. Në rastin kur, objekti i procedurës së përzgjedhjes përbëhet nga disa shërbime, shumatorja e çmimeve për njësi është _____
3. Burimi i financimit: _____

2.2 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

ose

Fillon më mbaron më

2.3 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Seksioni 3: Procedura

3.1 Lloji i procedurës:

Procedurë për përzgjedhjen e një ofruesi për shërbimit/ve _____ me vlerë nën 20.000.000 Lekë

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët **20**

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

3.3 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e propozimeve:

Data: / / (d/m/v) ora:

Vendi: _____

3.4 Gjuha(ët) në të cilat mund të hartohen propozimet:

Shqip

Anglisht

Seksioni 4: Informacione shtesë:

4.1 Informacione shtesë të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/Bashkia:

Shtojca 2

FORMULARI I PROPOZIMIT

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF i ftuar për të paraqitur ofertën)

Data: _____

Emri i OJF dhe NIPT-i (emri i OJF ofertuese dhe NIPT-in) _____

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së publikuar]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/ Bashkia Tiranë, në përputhje me Dokumentet (shih më poshtë), Shërbimet për _____ në përputhje me Propozimin Teknike, Propozimin Financiare (Buxhetin) dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumenta.
- c) Propozimi ynë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme;
 1. Njoftimin e kontratës;
 2. Kriteret e përzgjedhjes;
 3. Termat e Referencës;
 4. Listat e Çmimeve të Shërbimeve (nëse është e aplikueshme).
- ç) Çmimi total i Propozimit sonë, **pa TVSH**, është: _____ **[OJF ofertuese vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të OJF-së	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3

PROPOZIMI FINANCIAR (BUXHETI)

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF-të)

Data: _____

Emri i OJF /ve (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e propozimit.

Propozimi financiar (Buxheti)

1	2	3	4	5
	Përshkrimi	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4)
	Shpenzime të Përgjithshme të Administrimit			
1	Burime njerëzore			
	TOTAL 1 Burime Njerezore			
2	Shpenzime të tjera administrative			
	2.1 Shpenzime për ndriçim			
	2.2 Shpenzime për ngrohje			
	2.3 Shpenzime Uji			
	2.4 Të tjera			
	TOTAL 2 Shpenzime të tjera Administrative			
	TOTAL 1+2			
3	Aktivitete			
	3.1 Shërbim rezidencial për x përfitues			
	3.1.1 Shërbim Psikologjik (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.2 Punonjes sociale (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.3 Operatore sociale (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.4 Punonjës mbështetës (sanitar + guzhinier....) nr pers x nr muajsh			
	3.1.5 Ushqim 15 persona x Y dite			
	3.2 Shërbime social kulturore			
	3.2.1 Mesuës fiskulture			
	3.2.2 Mesues muzike/ arti			
	3.2.3 Abone 15 persona x nr muajsh			
	TOTAL 3 Aktivitete			

4	Furnitura			
	4.1 Set ngrenie për 15 persona (pirunj, luge, thika)			
	4.2 Detergjente të ndryshëm (për larje enesh, dysheme, banjo)			
	4.3 Set carcafe, batanie, jorgane, jastike , peshqire për 15 persona			
	4.4 Paketa higjene personale (paste dhembesh, furce dhembesh, sapu tualeti, kreher, lines,)			
	TOTAL 4 Furnitura			
5	Vizibiliteti 3%			
	5.1 Baner			
	5.2 Fletpalosje			
	5.3 Ndërtim ëeb për shërbimin			
	TOTAL 5 Vizibiliteti			
6	TOTAL 1+2+3+4+5			
7	Shpenzime të paparashikuara 1-7% e TOTALIT 6			
8	TOTAL 6+7			
Çmimi Neto pa TVSH				
TVSH (%)				
Çmimi total me TVSH:				
Emri i përfaqësuesit të OJF-së/ve				
Nënshkrimi				
Vula				
Datë _____				

Shtojca 4

FORMULARI I KRITEREVE TË PRANIMIT

(Bashka Tiranë)

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT

OJF-ja deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë shërbimin e kërkuar, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ekzekutiv, që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OJF-së, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale;
- d) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për OJF-të, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Propozim të pavarur, sipas kërkesave ;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, Të gjitha dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të OJF në ditën e hapjes së propozimit, sipas Shtojcës.

Në rast bashkimi të dy apo më shumë OJF, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk ndryshohen nga Bashkia Tiranë.

Në çdo rast, Bashkia Tiranë ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga OJF për sa më sipër.

- Nëse propozimit paraqitet nga një bashkim OJF-sh, do të paraqitet :
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. OJF duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës;*
- b. *Termet e Referencës për Shërbimin, sipas Shtojcës;*
- c. *Afatin i ekzekutimit sipas Shtojcës ;*

2. OJF duhet të paraqesë:

- a. Kapaciteti profesional /ekonomik dhe financiar /teknik të OJF

- b. Te tjera

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 5

KRITERET E PËRZGJEDHJES

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë)

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për OJF-të e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e propozimeve janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 20 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një propozim do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e OJF-ve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....$$

Ku:

Po - janë pikët totale të propozimit të vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmax1/Ok1$$

Pk1 Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmax1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i propozimit për kriterin që vlerësohet

Shtojca 6

TERMAT E REFERENCËS PËR SHËRBIMET

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë)

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

Shtojca 7

AFATI I EKZEKUTIMIT

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë)

Sasia e Shërbimit që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Çdo e dhënë tjetër që përshkruan kërkesat e objektit të procesurës së përzgjedhjes dhe vlerësohet e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës : _____

Shtojca 8

FORMULARI PËRMBLEDHËS I DEKLARIMIT

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF)

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të përfaqësuesit ligjor të OJF deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë si vijon:

Pjesa I: Informacion në lidhje me OJF-n

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i OJF: (Ju lutemi renditni të gjithë OJF nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e OJF në BOE)	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

OJF është i regjistruar në regjistrin zyrtar sipas legjislacionit shqiptar në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e shërbimit të kërkuar, dhe ka statusin aktiv.

OJF nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata.

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OJF-së/ve, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, etj.

OJF nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

OJF nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

OJF ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi,

OJF ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për OJF-të, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

OJF ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

OJF nuk është në listën e OJF-ve të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Propozimeve të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të OJF, në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- ▶ Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- ▶ Unë kuptoj që propozimi i paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
- ▶ Unë jam i autorizuar nga OJF të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të saj;
- ▶ Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga OJF për të përgatitur dhe për të nënshkruar propozimin në interes të OJF-së;
- ▶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe propozimit të paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo OJF tjetër ekonomik, të ndryshëm nga OJF, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - paraqesin një propozim në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, të bërë nga Autoriteti / Bashkia;
 - është një propozim i mundshëm i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një propozim në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës.
- ▶ OJF deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - OJF ka përgatitur propozimin e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - OJF është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë. OJF deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e këtij propozimi, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e

konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

- ▶ Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një propozim; ose,
 - paraqitjen e një propozimi që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për propozim.
- ▶ Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
- ▶ Kushtet e propozimit nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga OJF konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të OJF, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e OJF-së, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive,

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e titullatit të OJF, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
<ul style="list-style-type: none"> OJF _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. OJF_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. OJF_____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. 	
Nese ka mase Ligjore ne fuqi te jepen sqarime_____	

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e OJF, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e procedurës së përzgjedhjes, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave / dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Bashkia Tiranë), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me kërkesat dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Bashkia Tiranë.	
Emri, Mbiemri _____	
Firma _____	
Vula _____	
Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim OJF të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në çdo rast, Bashkia Tiranë ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e OJF jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, në Bashkinë Tiranë.
- OJF që marrin pjesë në procedurë duhet të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Shënim:

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Bashkia Tiranë duhet t'i kërkojë OJF fituese që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku Bashkia Tiranë mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Shtojca 9

FORMULARI I NJOFTIMIT TË PROPOZIMIT RENDITUR I PARI

(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

(Shtojcë për t'u plotësuar nga bashkia Tiranë)

Data: _____

Drejtuar: [Emri dhe adresa e OJF fitues] _____

Procedura _____

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, propozimi ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Me anë të kësaj ju informojmë se OJF/të e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i OJF

Numri i NIPT-t

Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i OJF

Numri i NIPT-t

Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar OJF e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i OJF

Numri i NIPT-t

Arsyet

2. _____

Emri i plotë i OJF

Numri i NIPT-t

Arsyet

Ankesa: PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

[Titullari i autoritetit /Bashkisë]

Shtojca 10

FORMULARI I ANKESËS

(Pranë Bashkisë Tiranë)

Ankesë drejtuar: _____

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një OJF ose disa OJF

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Nuis/Nipt

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E mail

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

Lloji i Procedurës: Përzgjedhja e OJF-së për realizimin e shërbimeve sociale _____

1. Emri i personit që administron procesin.

2. Vlera e përlogaritur e procedurës

3. Objekti i kontratës

(Përshkrimi i shkurtër i / shërbimeve objekt kontrate)

5. Afati i fundit për paraqitjen e propozimit

(Data (viti/muaji/dita)

6. Data e publikimit të Njoftimit të propozimit fitues

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

7. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. **Baza ligjore** (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të procedurës
- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të propozimeve lidhur me skualifikimin e propozimin tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit lidhur me kualifikimin e propozimit të një/disa OJF/ve pjesëmarrës në procedurë.

(Citoni OJF-në/të për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonit pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e Bashkisë Tiranë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonit)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në Bashkinë Tiranë.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Bashkisë Tiranë** _____ .

Nr. i faksit: _____

E-mail: _____

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit: _____

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar: _____

Shtojca 11

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)

1. Emri dhe adresa e Bashkisë Tiranë

Emri _____

Adresa _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ëeb-faqe _____

2. Objekti i kontratës _____

3. Vlera e përlogaritur e kontratës _____

4. Vlera totale përfundimtare e kontratës :

Vlera _____ Monedha _____
(me TVSH)

Vlera e nënkontraktimit _____ Monedha _____
(me TVSH)

5. Data e nënshkrimit të kontratës _____

6. Emri dhe adresa e Kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Numri i NIPT-it _____

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË ANULIMIT

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Bashkia Tiranë)

1. Emri dhe adresa e Bashkia Tiranë

Emri _____

Adresa _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

2. Objekti i Kontratës _____

3. Vlera e përlogaritur e kontratës _____

4. Arsyet e Anulimit

5. Informacion shtesë

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

